

Informacione  
për të huajt



Mirë se vini  
në kantonin Schwyz





# Ku mund të gjej atë që kërkoj?

Përmbledhja	5
Parathënia	7
Komuna Juaj, kantoni Schwyz dhe Zvicra	8
Skema e kantonit Schwyz	9
Vlerat themelore	10
Rregullimi i qëndrimit	11
Banimi	13
Gjuha dhe bashkëjetesa	14
Emergjenca	15
Shëndetësia	16
Martesa, lindja dhe vdekja	17
Fëmijët	18
Shkolla arsimit	19
Puna	21
Tatimet	23
Siguria sociale	24
Besimet fetare	26
Kultura dhe koha e lirë	27
Lëvizshmëria	28
Adresa të dobishme	29
Njoftim ligjor	30





## Mirë se vini në kantonin Schwyz!

### Aktivitetet që ndërlidhën mes veti

- Pjesëmarrja Juaj në jetën e komunës është e mirëseardhur.
- Pjesëmarrja në shoqata e ndihmon integrimin.
- Mësimi i gjuhës gjermane e lehtëson jetën.
- Lidhja e kontakteve është më e lehtë nëse kuptoni Schweizerdeutsch (gjermanishten që flitet në Zvicër).

**Administrata komunale ofron informacionet të nevojshme!**

### Vlerat themelore të shoqërisë sonë

- Respektimi i dinjitetit njerëzor
- Barazia mes mashkullit dhe femrës
- Liria e besimit fetar
- Respektimi i shtetit juridik
- Format demokratike të vendimmarrjes

**Sqarime rreth vlerave themelore mund ti gjeni në Kushtetutën Federale!**

### Të drejtat dhe detyrimet tuaja

- Respektimi i të drejtave të personalitetit tuaj është e drejtë e juaja.

Detyrimet tuaja kryesore janë:

- Përgjegjësia personale
- Respektimi i vlerave themelore të shoqërisë.
- Obligimi i lajmërimit, pagimit të tatimeve dhe sigurimeve si dhe i dërgimit në shkollë të fëmijëve tuaj.

**Informohuni pranë qendrave përkatëse!**

### Ne ju përkrahim gjatë integrimit tuaj

- Administrata komunale ofron informacione rreth mundësive lokale të integrimit si dhe kurseve për mësimin e gjuhës gjermane.
- Qendra këshilluese KomIn ofron konsulencë në çështjet rreth integrimit.

**Shih dosjen tonë me informacione!**



# Parathënie

## Mirë se vini në kantonin Schwyz!

Ju keni ardhur të jetoni në kantonin Schwyz. Shpresojmë, që së shpejti ta ndieni veten këtu si në shtëpinë tuaj. Informacionet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë të orientoheni në kanton.

Kantoni Schwyz shquhet për komplekse të bukura banimi, sistem të mirë arsimor, strukturë efikase të qarkullimit rrugor si dhe për një ambient të shëndoshë me mundësi të mëdha për pushim.

Vendimtare për një jetë cilësore është megjithatë një bashkëjetesë e mirë e të gjithë banorëve.

Lidhni kontakte me fqinjët tuaj, në komunë ose në shoqata. Pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore është e mirëseardhur! Mësoni sa më shpejt gjermanishten dhe përpiquni të kuptoni schweizerdeutsch (gjermanishten që flitet në Zvicër). Kjo do t'ju lehtësojë shumë mundësinë e lidhjes së kontakteve!

Vlera themelore të bashkëjetesës sonë janë respektimi i dinjitetit njerëzor, barazia mes mashkullit dhe femrës, liria e besimit fetar, respektimi i shtetit juridik si dhe i formave demo-kratike të vendimmarrjes. Nga ju presim që të respektoni këto vlerave themelore.

Bashkëjetesa mund të funksionojë vetëm atëherë kur të gjithë gëzojnë të drejtat dhe përbushin detyrimet e tyre. Tek të drejtat e Juaja hyn p.sh. mbrojtja e sferës suaj private, e drejta për të kërkuar ndihmë në rast nevoje, liria e besimit fetar, liria e marrjes së vendimeve sipas ndërgjegjes suaj si dhe e drejta e mendimit të lirë. Nga këto të drejta rrjedhin edhe detyrimet tona. Liria personale nuk mund të shfrytëzohet për të kufizuar lirinë e të tjerëve. Të gjithë duhet të japin kontributin e tyre për funksionimin e shtetit duke respektuar ligjet dhe rregullat shtetërore si dhe duke paguar tatimet.

Mos hezitoni t'iu drejtoni qendrave përkatëse administrative nëse keni ndonjë pyetje. Pika e parë e referimit është gjithnjë administrata komunale. Komln, qendra e kompetencës për integrim në Goldau dhe Pfäffikon mund t'ju ndërmjetësojë informata personale si dhe t'ju këshillojë gjatë integrit tuaj.



**Kurt Zibung**

Drejtuesi i departamentit të ekonomisë

## Zbulojeni dhe eksplorojeni kantonin Schwyz! Ne do t'ju ndihmonim me kënaqësi!

Drejtuesi i departamentit të ekonomisë

Kurt Zibung, Regierungsrat

---

# Komuna Juaj, kantoni Schwyz dhe Zvicra

---

Zvicra përbëhet nga 26 kantone. Zvicra është e njohur si federatë ose edhe si konfederatë.

Kantoni Schwyz përfshin 6 qarqe dhe 30 komuna. Federata, kantonet, qarqet dhe komunat përmbushin detyra të ndryshme.

## **Cilat detyra përmbush komuna?**

Administrata komunale është pika e parë e referimit për pyetjet dhe çështjet tuaja.

Ndër detyrat e komunës janë p.sh.:

- Regjistrimi i të gjithë banorëve
- Mbështetja e integritetit të qytetarëve të huaj
- Organizimi i shkollës fillore
- Dhënia e ndihmës sociale për banorët e saj
- Sigurimi i infrastrukturës si p.sh. uji dhe mbledhja e mbeturinave.



Nëse dëshironi më shumë informacione, atëherë caktoni një takim në qendrën përkatëse. Sillni me vete një përkthyes ose një përkthyes nëse keni nevojë (shikoni «Adresa të dobishme»).

## **Cilat detyra përmbush qarqet?**

Qarqet merren kryesisht me organizimin e mësimdhënies në shkolla të mesme si dhe të gjykatave. Qarqet Gersau, Küssnacht dhe Einsiedeln kryejnë njëkohësisht edhe detyrat si komunë.

## **Cilat detyra përmbush kantoni?**

Kantoni përmbush detyrat që kanë të bëjnë me të gjitha komunat si p.sh. spitalet dhe policia.

Kantoni mban kontaktet me kantonet e tjera dhe me federatën. Ai mbikëqyr ekzekutimin dhe respektimin e ligjeve federative.

## **Cilat detyra përmbush federata?**

Zvicra është zhvilluar hap pas hapi përmes bashkimit të kantoneve të ndryshëm. Federata ekziston në formën që ka sot që nga viti 1948.

Federata përmbush detyra që kanë të bëjnë me Zvicrën në tërësi dhe që vlejnë në të gjithë Zvicrën. Këtu hyjnë p.sh. çështjet e politikës së jashtme ose rregulloret për qëndrimin e qytetarëve të huaj në Zvicër.

## **Kush vendos për veprimet shtetërore?**

Qytetarët e Zvicrës gëzojnë të drejta të gjera demokratike. Ata nuk zgjedhin vetëm parlamentin dhe qeverinë por votojnë rregullisht edhe për çështje të tjera faktike.


# Skema e kantonit Schwyz

Popullata (në fund të vitit 2008): 143 605

Sipërfaqja: 908,2 km<sup>2</sup>

Hyrja në konfederatë: 1291

Capital: Schwyz



- = Innerschwyz
- = Ausserschwyz
- = Kantoni
- = Qarku
- = Komuna



# Vlerat themelore



Ligji themelor i Zvicrës është kushtetuta federative. Kushtetuta federative i përcakton të drejtat dhe rregullat themelore për bashkëjetesën si dhe marrëdhëniet ndaj shtetit. Kushtetuta federative i përcakton kompetencat dhe detyrat e federatës dhe të kantoneve. Kushtetuta federative vlen për të gjithë Zvicrën. Secili kanton përveç kësaj e ka një kushtetutë kantonale.

## **Cilat janë të drejtat dhe detyrimet më të rëndësishme?**

Kantoni Schwyz i kushton rëndësi mbrojtjes së lirisë së çdo njeriu si dhe respektimit të rregullave të bashkëjetesës. Kjo supozon që të gjithë të gëzojnë të drejta të njëjtat dhe te orarajne bashkëjetesen.

Disa nga vlerat thelbësore më të rëndësishme janë:

- Respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor.
- Të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit.
- Mashkulli dhe femra janë të barabartë.
- Liria e individit kufizohet nga liria e tjetrit.
- Ligjet dhe rregullat te shtetit duhen respektuar.

Ata që jetojnë në Zvicër duhet ti përmbushin edhe detyrimet e mëposhtme:

- Të gjithë duhet të japin kontributin e tyre për mbulimin e shpenzimeve shtetërore dhe të paguajnë tatimin.
- Sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm (shih «Siguria sociale» dhe «Shëndetësia»).
- Te gjithë ata që punojnë duhet të japin kontributin e tyre social (shih «Puna» dhe «Siguria sociale»).
- Shkollimi i fëmijëve është i detyrueshëm. Prindërit duhet të bashkëpunojnë me personelin arsimor (shih «Shkolla, arsimit»).

## **Çfarë pret Zvicra nga të ardhurit?**

Zvicra pret nga ju që të interesoheni për marrëdhëniet shoqërore dhe rrethanat jetësore të vendit dhe të konfrontoheni me to. Keni në dispozicion shumë alternativa:

- Bisedat me fqinjët
- Anëtarësimi në një shoqatë
- Pjesëmarrja në aktivitete
- Pjesëmarrja në ritet dhe zakonet
- Puna vullnetare në sferën kulturore, sportive dhe sociale.

Të gjithë të ardhurit do duhet mësuar njëri nga gjuhët anëtare. Në kantonin Schwyz pri-tet nga ju që të mësoni gjermanishten.

# Rregullimi i qëndrimit

## **Si rregullohet çështja e qëndrimit tim pas hyrjes në Zvicër?**

Të gjithë personat që vijnë në Zvicër pajisen fillimisht me një leje qëndrimi me afat të kufizuar.

Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë në Zvicër duhet të lajmërohen në komunën përkatëse brenda afatit 14 ditësh dhe patjetër para fillimit të punës.

Dikasteri komunal për banorët duhet njoftuar për çdo ndërrim banese (edhe brenda komunës) ose largim të tërësishëm.

Leja e qëndrimit duhet vazhduar më së voni dy javë para skadimit të afatit.

## **A duhet ta mbaj me vete letërnjoftimin për të huajt?**

Nuk jeni i detyruar ta mbani gjithmonë me vete letërnjoftimin për të huajt. Nëse kërkohet nga ju, atëherë këtë letërnjoftim duhet t'ia tregoni organeve shtetërore, si p.sh. policisë. Letërnjoftimi i duhet treguar edhe punëdhënësit me kërkesën e tij.

## **Çfarë nënkupton autorizimi i përhershëm i qëndrimit?**

Autorizimi i përhershëm i qëndrimit është një leje qëndrimi me afat të pakufizuar. Personat me këtë leje qëndrimi kanë të drejtë ta zgjedhin vetë punëdhënësin e tyre. Ata nuk paguajnë tatim burimor por deklarojnë tatimin e tyre përmes një formulari përkatës.

Autorizimi i përhershëm i qëndrimit bëhet i pavlefshëm nëse ç'lajmëroheni ose largoheni nga Zvicra për më shumë se 6 muaj dhe nuk i keni paraqitur Zyrës për Çështje të Emigracionit një kërkesë për mbetjen në fuqi të lejes së qëndrimit.

## **Si mund ta marr shtetësinë zvicerane?**

Administrata komunale ofron informacione rreth kushteve për marrje së shtetësisë zvicerane.

## **Çfarë duhet të bëj nëse dëshiroj të ftoj të afërmit e mi?**

Shtetasit e huaj që dëshirojnë të vijnë në Zvicër duhet të jenë të pajisur me një dokument udhëtimi të njohur zyrtarisht nga Zvicra.

Nëse të afërmit tuaj vijnë nga vende për të cilat kërkohet një vizë, atëherë ata duhet të pajisen me vizë hyrëse. Personi që i fton është i detyruar të bartë të gjitha shpenzimet që do të lindin nga qëndrimi i shtetasit të huaj. Prandaj duhet lidhur një kontratë sigurimi për udhëtarë me një mbulesë prej së paku 50 000 Frangash Zvicerane.

Lidhja e kontratës së sigurimit rekomandohet edhe për rastet në të cilat të afërmit tuaj nuk kanë nevojë të pajisen me vizë hyrëse.

Personat që nuk punojnë mund të qëndrojnë në Zvicër 3 muaj pa pasur nevojë për leje qëndrimi. Brenda një periudhe 6-mujore lejohet një qëndrim prej gjithsej 3 muajsh. Personat të cilëve iu nevojitet viza hyrëse duhet të respektojnë afatin e qëndrimit të përcaktuar në vizë.



## **Rregulla për shtetas të Unionit Evropian / EFTA-s**

### **A mund të vijë edhe familja ime?**

Pjesëtarët e familjes suaj mund të vijnë në Zvicër pavarësisht nga nënshtetësia e tyre nëse keni një banesë me madhësi të mjaftueshme.

Si pjesëtarë të familjes llogariten bashkëshorti, fëmijët dhe nipërit e mbesat nëse nuk e kanë mbushur moshën 21 vjeç ose nëse paguani alimentacione për ta, prindërit, gjyshi dhe gjyshja nëse ju i mbuloni shpenzimet e tyre. Studentët mund të marrin me vete vetëm bashkëshortin si dhe fëmijët të cilet ushqehen nga ai.

### **A mund ta ndërroj vendin e punës dhe vendbanimin?**

Vendin e punës dhe vendbanimin mund ta zgjidhni sipas dëshirës suaj.

### **Kur e marr autorizimin e përhershëm të qëndrimit**

Shtetasit e 15 shteteve të vjetra të Bashkimit Evropian si dhe të EFTA-s e marrin autorizimin e përhershëm të qëndrimit pas 5 viteve të një qëndrimi të pandërprerë në Zvicër.

## **Rregulla për shtetas jashtë Unionit Evropian / EFTA-s**

### **A mund të vijë edhe familja ime?**

Ju mund ta merrni familjen tuaj, respektivisht bashkëshortin dhe fëmijët e pamartuar të moshës nën 18 vjeçare nëse familja jeton bashkë, keni banesë të mjaftueshme për të gjithë dhe nuk jeni i varur nga ndihma sociale. Kërkesa për tërheqjen e familjes duhet bërë brenda 5 vjetësh. Fëmijët mbi 12 vjeç duhet tërhequr brenda 12 muajsh. Në shtete të caktuara, bashkëshorti dhe fëmijët duhet të paraqiten personalisht në përfaqësinë tonë dhe të kalojnë nëpër procedurën e rregullt për marrjen e vizave.

### **A mund ta ndërroj vendin e punës dhe vendbanimin?**

Ndërrimi i vendit të punës duhet të miratohet nga Zyra për Çështje të Emigracionit në qytetin ku ndodhet selia e punëdhënësit tuaj. Para kalimit të vendbanimit në një kanton tjetër duhet marrë aprovimi i kantonit në të cilin shkoni.

### **Kur e marr autorizimin e përhershëm të qëndrimit?**

Shtetasit jashtë Unionit Evropian /EFTA-s mund ta marrin autorizimin e përhershëm të qëndrimit pas një qëndrimi të rregullt dhe të pa ndërprerë prej 10 vjetësh. Për shtetasit e SH-BA-ve, por edhe të shteteve të tjera në rrethana të posaçme miratimi mund të jepet edhe pas 5 vjetësh. Ju nuk keni të drejtë të kërkonti që patjetër t'ju miratohet autorizimi i përhershëm.



# Banimi



## Si banohet në Zvicër?

Shumica e banorëve të Zvicrës jetojnë në banesa me qira. Oferta për banesa me qira mund të gjeni në shumicën e gazetave regjionale si dhe në internet.

Para hyrjes në banesë duhet lidhur një kontratë me qiradhënësin. Në shumicën e rasteve kërkohet depozitimi si siguri i një shumë e caktuar në një konto të bllokuar.

Për prishjen e kontratës duhet respektuar afati për prishje i shënuar në kontratë. Ekziston mundësia e prishjes së parakohshme të kontratës nëse gjeni një pasardhës që ka mjete të mjaftueshme financiare për të paguar qiranë.

Dikasteri për ndërmjetësim ndihmon në rastet kur keni grindje me qiradhënësin gjatë kohës së banimit ose prishjes së kontratës.

## A ka të drejtë gjithkush të blejë pasuri të patundshme për banim?

Të njëjtat të drejta si shtetasit zviceranë për blerjen e pasurisë së patundshme për banim në Zvicër i gëzojnë vetëm shtetasit e Unionit Evropian / EFTA-s me banim në Zvicër.

## Çfarë shpenzimesh të tjera ka?

Kërkesa për linjë telefonike mund të shtrohet tek njëra nga shoqëritë telefonike.

Edhe shpenzimet për rrymë elektrike, ujë, ngrohje dhe kablllo televiziv paguhen jashtë qerasë. Pjesërisht këto shpenzime i faturon qiradhënësi juaj.

Tarifa të caktuara paguan gjithashtu edhe çdo banor i cili ka radio ose televizion.

## Ku duhen hedhur mbeturinat?

Komuna në të cilën banoni përmes një broshure ju ofron informacione rreth administrimit të mbeturinave.

Oferta për banesa: [www.homegate.ch](http://www.homegate.ch),  
[www.immoscout24.ch](http://www.immoscout24.ch)

Fleta informative – banim (11 gjuhë): [www.bwo.admin.ch](http://www.bwo.admin.ch) > Dokumentation > Publikationen > Infoblatt Wohnen

Dikasteri për ndërmjetësim: [www.sz.ch/miete](http://www.sz.ch/miete)

Blerja e pronës së patundshme: [www.sz.ch/lexkoller](http://www.sz.ch/lexkoller)

Televizioni dhe radioja: [www.billag.ch](http://www.billag.ch)

# Gjuha dhe bashkëjetesa

## **Ku mund të mësoj gjermanisht?**

Është e nevojshme ta kuptoni dhe ta flisni gjuhën gjermane për t'u njohur me fqinjët dhe për t'i kuptuar ata, për t'u informuar rreth kantonit në të cilin jetoni, për të ditur se çfarë mësojnë fëmijët tuaj në shkollë si dhe për të folur me mësuesit dhe mësueset e tyre, për ta pasur më të lehtë kontaktin me organet shtetërore si dhe për ta ndier veten më mirë në kantonin Schwyz.

Administrata komunale ofron informacione rreth mundësive për mësimin e gjermanishtes. Nëse ju nevojitet ndihmë gjatë kërkimit të një oferte të përshtatshme mund t'i drejtoheni edhe KomIn, qendrës së kompetencës për integrim (Nr. i telefonit 055 410 28 55).

## **A duhet të mësoj patjetër «Schweizerdeutsch» (gjermanishten që flitet në Zvicër)?**

Zviceranët e dinë se është mjaft vështirë të mësohet gjuha e tyre schweizerdeutsch. Përpjekjet e të huajve për ta kuptuar këtë gjuhë e lehtësojnë mjaft kontaktin.

## **Kush i ndërmjetëson përkthyesit?**

Kur keni për të zhvilluar biseda të rëndësishme rekomandohet të sillni me vete një përkthyes të kualifikuar. Përkthyesit ndërmjetësohen nga Dolmetschdienst Zentralschweiz (Shërbimi i përkthimit i Zvicrës Qendrore). Nr. i telefonit është: 041 368 51 51.

## **Si mund të lidh kontakte?**

Një mundësi e mirë për të lidhur kontakte është anëtarësimi në një shoqatë. Jeta shoqërore në komuna dhe kantone zhvillohet kryesisht në shoqata.

Në shumë prej komunave ka shoqata të posaçme për gra, për prindër ose për të rinj. Shoqatat e ndryshme sportive mundësojnë një organizim kuptimplotë të kohës së lirë.

Informacione rreth shoqatave në vendbanimin tuaj ofron administrata komunale.

KomIn, qendra e kompetencës për integrim ofron informacione, rreth shoqatave të huajve.



Qendra e kompetencës për integrim: [www.kom-in.ch](http://www.kom-in.ch)

Oferta për integrim në Zvicrën Qendrore: [www.integration-zentralschweiz.ch](http://www.integration-zentralschweiz.ch)

Shoqata të grave: [www.frauenbund.ch](http://www.frauenbund.ch)

Shoqata zvicerane e futbollit: [www.football.ch](http://www.football.ch)

Kisha katolike: [www.sz.kath.ch](http://www.sz.kath.ch)

Kisha evangjeliste: [www.ref-sz.ch](http://www.ref-sz.ch)

Jungwacht dhe Blauring (Shoqatë për fëmijë): [www.jubla.ch](http://www.jubla.ch)

Shoqata e vezhguesve: [www.pfadischwyz.ch](http://www.pfadischwyz.ch)

# Emergjenca



## Numrat më të rëndësishëm të telefonit për raste urgjente

**Policia: 117**

**Zjarrfikësit: 118**

**Ndihma e parë: 144**

## Në rast urgjence kërkohen nga ju informacionet e mëposhtme:

- Pozicioni i saktë i vendit të emergjencës?
- Çfarë ka ndodhur?
- Numri i juaj i telefonit nëse lind nevoja t'ju marrin në telefon?

## Kush ndihmon nëse ka probleme mjekësore?

Nëse keni ndonjë problem mjekësor duhet të merrni në telefon fillimisht mjekun tuaj personal. Nëse mjeku juaj nuk lajmërohet, atëherë vlejné numrat e mëposhtëm:

Regjioni Küssnacht (Qarku Küssnacht)	Telefoni 0840 61 61 61
Regjioni Arth-Goldau (Arth, Steinerberg, Steinen Lauerz)	Telefoni 0840 71 71 71
Regjioni Schwyz (Qarku Gersau und qarku Schwyz pa Alpthal, Ober- dhe Unteriberg)	Telefoni 0840 31 31 31
Regjioni Einsiedeln (Qarku Einsiedeln dhe Alpthal, Ober- dhe Unteriberg)	Telefoni 0840 41 41 41
Regjioni Höfe (Qarku Höfe)	Telefoni 0840 81 81 81
Regjioni March (Qarku March)	Telefoni 0840 51 51 51

## Kush ndihmon nëse kam dhimbje dhëmbi?

Nëse keni dhimbje dhëmbi duhet të merrni në telefon fillimisht dentistin tuaj personal. Nëse mjeku juaj nuk lajmërohet, atëherë vlejné numrat e mëposhtëm:

Regjioni Ausserschwyz	Telefoni 0840 800 810
Regjioni Innerschwyz	Telefoni 0840 840 810

## Kush ndihmon në rastet e dhunës në familje?

Personat ndaj të cilëve ushtrohet dhunë në familje mund t'i drejtohen qendrës këshilluese të kantonit Schwyz për ndihmë ndaj viktimave (Nr. i telefonit: 0848 82 12 82).

Për femrat kantoni Schwyz vë në dispozicion qendrën informative dhe këshilluese për gratë (Nr. i telefonit: 0800 00 30 30).

Meshkujt që kanë ushtruar dhunë mund t'i drejtohen qendrës profesionale kundër dhunës së meshkujve në Luzern (Nr. i telefonit: 078 744 88 88) ndërsa femrat shërbimit për lirim me kusht (Nr. i telefonit: 041 819 16 75).

## Kush ndihmon kur lindin probleme personale?

Nëse keni probleme personale mund të merrni në numrin e telefonit 143. Ky numër është gratis dhe mund të merret si ditën ashtu edhe natën.

Këshillime ofron edhe bashkia kishtare si dhe bashkësia juaj fetare.

# Shëndetësia

## Çfarë mund të bëj kur jam sëmurë?

Në Zvicër zakonisht secili person e zgjedh një mjek personal (mjeku i shtëpisë, mjekja e shtëpisë). Ky mjek është pika juaj e parë e referimit nëse keni probleme shëndetësore, por edhe në raste urgjente si gjatë natës ashtu edhe gjatë fundjavës. Nuk praktikohet direkt të vizitohet spitali.

## Kush i bart shpenzimet e mjekimit?

Çdo person me banim në Zvicër është i obliguar që brenda 3 muajsh nga arritja në Zvicër të lidhë një kontratë për sigurim shëndetësor (shih edhe «Siguria sociale»). Sigurimi është personal. Personat e rritur duhet të ndërmarrin vetë hapat e nevojshëm për t'u lajmëruar në një kompani për sigurime shëndetësore të zgjedhur nga ata. Fëmijët duhen siguruar brenda 3 muajsh nga lindja e tyre.

Çdo i siguruar paguan një tarifë individuale, të pavarur nga të ardhurat. Kjo tarifë ndryshon nga kompania në kompani por varet edhe nga vendbanimi dhe forma e sigurimit.

Kompania e sigurimit i mbulon shpenzimet e mjekimit në rast sëmundjeje, lindjeje si dhe në rast aksidenti nëse këto shpenzime nuk mbulohen nga kompania për sigurim ndaj aksidenteve.

Merren përsipër shpenzimet si për shërim ambulant ashtu edhe për shërim në spital si dhe medikamentet e rekomanduara nga mjeku. Personat e siguruar paguajnë një shumë minimale të caktuar më parë me kontratë si dhe për ekskluzivitetet e zgjedhura.

Shteti iu ndihmon personave me të ardhura modeste duke e ulur tarifën që duhet paguar.

## Kush i mbulon shpenzimet e mjekimit pas një aksidenti?

Personat që punojnë në marrëdhënie të rregullta pune minimumi 12 orë në javë janë të siguruar edhe në rastet kur aksidentet ndodhin jashtë ndërmarrjes. Këta persona nuk kanë nevojë të sigurohen ndaj aksidenteve në kuadër të kompanisë së sigurimit shëndetësor.

## Ku merren medikamentet?

Shumë medikamente mund të merren në shitore të quajtura Drogerie ose në barnatore. Medikamentet që mund të merren vetëm me recetë të mjekut jepen drejtpërdrejt nga mjeku ose në barnatore.

## Kush i mbulon shpenzimet për mjekimin e dhëmbëve?

Shpenzimet për mjekimin e dhëmbëve i bart secili vetë. Ekziston mundësia e sigurimeve të veçanta për këto mjekime.

## Kush përkujdeset në shtëpi?

Të afërmit që kanë nevojë në shtëpi për përkujdesje të përhershme mund t'i drejtohen Spitex – përkujdesjes jashtë spitalore për të sëmurët. Mjeku i shtëpisë ose shërbimi i punës sociale në spital mund t'ju japin më shumë informacione lidhur me këtë.

Dikasteri për shëndetësi i kantonit Schwyz: [www.sz.ch/ags](http://www.sz.ch/ags)

Lirimi i tarifave: [www.ausgleichskasse.ch/sz](http://www.ausgleichskasse.ch/sz) > Dienstleistungen > Krankenversicherung

Krahasimi i tarifave të sigurimeve: [www.comparis.ch](http://www.comparis.ch)

Dikasteri federativ për shëndetësi: [www.bag.admin.ch](http://www.bag.admin.ch)

# Martesa, lindja dhe vdekja

## Çfarë duhet bërë para martesës?

Zyra e gjendjes civile e vendbanimit tuaj ju pajis me informacione rreth dokumenteve që nevojiten për një martesës si dhe e organizon martesën civile.

Ata që dëshirojnë që përveç martesës të lidhin edhe martesë sipas ceremonive dhe riteve fetare duhet ta organizojnë këtë në bashkëpunim me bashkësinë e tyre fetare.

## Ku duhet lajmëruar lindja e fëmijëve?

Lindja e fëmijëve lajmërohet në Zyrën e Gjendjes Civile. Duhet sjellë me vete lajmërimi i lindjes i plotësuar nga spitali ose nga mamia nëse ky dokument nuk është përcjellë drejtpërdrejt nga spitali.

Nëse synoni të keni një ceremoni fetare, këtë mund ta organizoni përmes bashkësisë suaj fetare.

## Çfarë duhet bërë në rast vdekjeje?

Në rast vdekjeje duhet lëshuar nga një mjek vërtetimi i vdekjes.

Pas kësaj duhet telefonuar me shërbimin e funeraleve, i cili do bënte vendosjen në arkiivol dhe transportin për në faltoren e varrezave ose në krematorium. Shërbimet e funeraleve në rast se dëshironi e bëjnë edhe dërgimin e kufomave në vendlindje. Shpenzimet e varrimit barren nga anëtarët e familjes.

Rastet e vdekjes duhen lajmëruar në Zyrën e Gjendjes Civile të vendit ku ka ndodhur vdekja ose në zyrën e komunës. Këto dokumente duhet sjellë me vete:

- Vërtetimi i vdekjes (nëse nuk përcillet drejtpërdrejt nga mjeku)
- Librin familjar ose vërtetimin i lindjes, nëse ekzistojnë
- Lejen e qëndrimit, respektivisht autorizimin e përhershëm të qëndrimit.

Informacione të mëtejme rreth mundësive të varrimit si dhe hapave të tjerë të nevojshëm ofron zyra komunale. Nëse dëshironi të organizoni një ceremoni fetare, atëherë këtë mund ta bëni përmes bashkësisë suaj fetare.

Nuk ka varreza të posaçme për bashkësi fetare jo krishtere.



# Fëmijët

## **Ku mund të informohen nënat dhe baballarët?**

Nëse ju keni dëshirë, atëherë personeli i pavijonit të lindjes e informon qendrën tuaj komunale të këshillimit për nënat dhe baballarët. Në këtë rast kjo qendër do të lajmërohet pas lëshimit nga spitali tek ju dhe do t'ju ofronte një vizitë në shtëpinë tuaj për të biseduar rreth pyetjeve dhe nevojave tuaja individuale.

Këshilluesit për nëna dhe baballarë do t'ju shoqëronin me kënaqësi në detyrën tuaj si prindër të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, do t'ju këshillonin në çështjet rreth ushqimit me gji të foshnjave si dhe problemeve eventuale, do të vëzhgonin dhe vlerësonin bashkë me ju zhvillimin e foshnjës ose të fëmijëve tuaj, do të bisedonin me ju rreth përshtatjes individuale të ushqimit për fëmijët tuaj, do t'ju përkrahnin gjatë përkujdesjes së fëmijëve të shëndoshë ose të sëmurë si dhe do të diskutonin me ju rreth çështjeve të edukimit të përgjithshëm.

## **Këshillime rreth çështjeve bashkëshortore dhe familjare?**

Nëse keni pyetje rreth partneritetit, jetës bashkëshortore, familjes, mbrojtjes ndaj shtatzënisë, ndarjes ose divorcit mund t'iu drejtoheni qendrave profesionale për këshillimin e çifteve dhe të familjeve në Goldau (Nr. i telefonit 041 859 17 37) dhe në Pfäffikon (Nr. i telefonit 055 410 46 44).

## **Kush përkujdeset për fëmijët?**

Përkujdesja ndaj fëmijëve në Zvicër është çështje që iu përket prindërve. Në shumë komuna ka oferta për përkujdesje ndaj fëmijëve (disa orë, gjysmë dite ose gjithë ditën). Për më shumë informacione mund t'iu drejtoheni administratës komunale.

## **Ku mund të blihen me çmime të lira veshje, mobilje dhe lodra?**

Në disa komuna mbahen rregullisht bursa me veshje për fëmijë të vegjël. Edhe Brockenhäuser (shitore me mallra të përdorura) ofrojnë një mundësi për të blerë me çmime të lira veshje, lodra dhe mobilje: Ato mund t'iu gjeni p.sh. në Brunnen (Kirchenriedweg 1), në Einsiedeln (Klostermühlestrasse 2) ose në Siebnen (Zürcherstrasse 29).



Këshillime për nëna dhe baballarë: [www.spitexsz.ch](http://www.spitexsz.ch)

Qendra për këshillimin e çifteve dhe familjeve: [www.spd.ch](http://www.spd.ch)

Oferta për përkujdesje ndaj fëmijëve: [www.spielgruppe.ch/verzeichnis](http://www.spielgruppe.ch/verzeichnis)  
[www.familienschwyz.ch](http://www.familienschwyz.ch)

[www.sz.ch/kinderbetreuung](http://www.sz.ch/kinderbetreuung)

Qendra ndërmjetësimi për familje ditore: [www.tagesfamilien.ch](http://www.tagesfamilien.ch)

Bursa me veshje për fëmijë: [www.kindex.ch](http://www.kindex.ch)

# Shkolla arsimit

## **Cilat shkolla ekzistojnë?**

Të gjithë fëmijët shkojnë një vit në çerdhe (Kindergarten) dhe pastaj 6 vjet në shkollën fillore (Primarschule). Pas kësaj bëhet kalimi në shkollën e parë të shkollës së mesme (Sekundarstufe I), e cila zgjat 3 vjet dhe udhëhiqet nga qarqet si shkollë me përqendrim të mesëm (Mittelpunktschule – MPS).

Shkolla publike popullore (Volksschule) është falas. Fëmijët mund të dërgohen edhe në shkolla private të pranuar nga shteti. Këto shkolla paguhet nga prindërit.

## **Sa zgjat obligimi për të ndjekur shkollën?**

Obligimi për të ndjekur shkollën zgjat gjithsej 10 vjet.

Viti shkollor në të gjitha shkollët fillon në mes të gushtit dhe mbaron në fund të korrikut. Këto pushime janë obligative dhe nuk mund të shtyhen në një periudhë tjetër.

## **Kush ndihmon nëse fëmija im ka nevojë për ndihmë në shkollë?**

Shkollat ofrojnë mundësi të ndryshme për përkrahjen e fëmijëve që kanë vështirësi në shkollë si p.sh. mësim shtesë të gjuhës gjermane. Lidhur me këtë mund të informoheni tek personeli arsimor.

## **Kujt mund t'i drejtohem nëse kam ndonjë pyetje?**

Personeli arsimor i përgjigjet me kënaqësi pyetjeve tuaja. Nëse lindin diferenca në bisedat e drejtpërdrejta mes jush dhe mësuesit dhe për prindërit nuk sqarohen çështjet në formën e dëshiruar, atëherë bisedoni me drejtuesit e shkollës.

## **Çfarë pritet nga prindërit?**

Prindërit ftohen rregullisht në mbledhje me prindër. Pritet që së paku njëri nga prindërit të marrë pjesë gjithmonë në këto mbledhje. Mësuesit mund t'i ftojnë prindërit edhe në biseda personale. Nëse keni vështirësi me gjuhën, atëherë rekomandohet marrja me vete e një përkthyesi.





### **Cilat janë alternativat për nxënësit pas përfundimit të kohës obligative shkollore?**

Shumica e të rinjve në Zvicër pas përfundimit të shkollës i nënshtrohet një arsimit bazë profesional (Lehre). Aty pajisen me një kualifikim profesion në praktikë në një ndërmarrje si dhe ndjekin mësimin në një shkollë profesionale. Kjo formë zgjat afërsisht 2–4 vjet.

Dy shkolla kantonale dhe tri shkolla private ofrojnë gjimnaze. Gjimnazi (Gymnasium) mbyllet me një maturë.

Shkolla e mesme komerciale (Handelsmittelschule – HMS) mund të ndiqet në shkollën kantonale Kollegium Schwyz KKS, ndërsa shkolla e mesme profesionale (Fachmittelschule – FMS) në Theresianum Ingenbohl.

Informacione dhe këshillime rreth zgjedhjes së profesionit si dhe gjatë kërkimit të një shkolle profesionale ofrojnë qendrat informative të profesioneve (BIZ).

Për të rinjtë, të cilët pas përfundimit të kohës obligative shkollore nuk gjejnë asnjë vend në një shkollë profesionale ka oferta të ndryshme për ta tejkaluar këtë.

### **Cilat janë mundësitë për financimin e arsimit profesional?**

Arsimi profesional pas përfundimit të kohës obligative shkollore zakonisht financohet nga prindërit. Nëse prindërit nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, atëherë mund të paraqitet një kërkesë për bursë.

### **Cilat janë mundësitë e arsimit për të rriturit?**

Institucione të ndryshme të vogla dhe të mëdha ofrojnë në kantonin Schwyz mundësi për arsimimin dhe kualifikimin e të rriturve.



Shkollat: [www.sz.ch/volksschulen](http://www.sz.ch/volksschulen)  
[www.sz.ch/mittelschulen](http://www.sz.ch/mittelschulen)

Këshillime për studime dhe profesione: [www.sz.ch/berufsberatung](http://www.sz.ch/berufsberatung)

Mundësitë e punësimit dhe arsimimit në Zvicër: [www.berufsberatung.ch/dyn/8188.aspx](http://www.berufsberatung.ch/dyn/8188.aspx)  
Jferta për periudha kalimtare: [www.sz.ch/Berufsbildung](http://www.sz.ch/Berufsbildung) > Berufsvorbereitung, Brückenangebote

Bursa: [www.sz.ch/stipendien](http://www.sz.ch/stipendien)

Arsimi për të rritur: [www.sz.ch/Berufsbildung](http://www.sz.ch/Berufsbildung) > Höhere Berufsbildung Weiterbildung

# Puna

## **Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësve dhe të punësuarve?**

Për të punuar në Zvicër nevojitet krahas lejes së qëndrimit edhe leja e punës. Varësisht nga nënshtetësia ka parakushte të ndryshme për ta marrë këtë leje.

Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punësuarit përcaktohen me kontratë. Në këtë kontratë caktohen edhe orët e përgjithshme të punës në javë. Orët e përgjithshme të punës në javë janë mesatarisht 42 orë, mirëpo ndryshojnë nga fusha në fushë.

Zakonisht marrëdhëniet e punës fillojnë me një periudhë prove prej më së shumti 3 muajsh. Gjatë kësaj periudhe kontrata e punës mund të priset nga të dy palët brenda një afati të shkurtër. Pas kalimit të periudhës së provës kontrata e punës mund të priset vetëm duke respektuar afatin e caktuar në kontratë.

Për marrëdhëniet e punës në firmat që huazojnë personel vlejnë rregulla të posaçme.

Të punësuarve iu takojnë me ligj së paku 4 javë pushime në vit. Deri në moshën 20 vjeçare iu takojnë më së paku 5 javë.

Grave në marrëdhënie pune dhe atyre që punojnë si të pavarura u takon pas lindjes një pushim prej minimumi 14 javësh.

## **Çfarë pagese mund të pres?**

Në Zvicër nuk ekziston një rrogë minimale e caktuar me ligj. Zakonisht marrëveshjet rreth rrogës lidhen individualisht mes punëdhënësit dhe të punësuarit. Në një numër të vogël rastesh, si p.sh. në gastronomi lidhen kontrata gjenerale pune.

Shuma e përcaktuar me kontratë është rroga bruto. Nga kjo rrogë hiqen shumat obligative për sigurimin social:

Sigurimi për pleqërinë dhe pasardhësit (Alters- und Hinterlassenenversicherung AHV)

Sigurimi për i invaliditetit (Invalidenversicherung IV)

Rregullorja për të ardhura alternative (Erwerbsersatzordnung EO)

Sigurimi për të papunët (Arbeitslosenversicherung ALV)

Sigurimi ndaj aksidenteve (Unfallversicherung UVG):

    Sigurimi ndaj aksidenteve në punë (Betriebsunfallversicherung BU)

    Sigurimi ndaj aksidenteve jashtë objektit punues (Nichtbetriebsunfallversicherung NBU)

Kasa e pensioneve (Pensionskasse BVG).

Për pagesën e ALV dhe BVG ka kufizime në bazë të rrogës.

Sipas kontratës dhe fushës mund të hiqen shuma shtesë për sigurimin e ditëve të sëmundjes ose një anëtarësi në sindikatë.

Punëdhënësi iu paguan institucioneve të sigurimeve sociale të njëjtat shuma si ju (me përjashtim të sigurimit ndaj aksidenteve jashtë objektit punues).



## **Kush i nje diplomat e mia jo zvicerane?**

Punëdhënësit në Zvicër i kushtojnë rëndësi të madhe diplomave dhe dëftesave të punës.

Zyra federative për arsimin profesional dhe teknologji BBT e gëzon të drejtën për të gjykuar ekuivalencën e dëftesave të huaja në të gjithë fushën e arsimit profesional dhe shkollave të larta profesionale. Kompetenca të tjera: Për diplomat universitare (Konferenca e rektorëve të universiteteve zvicerane), për profesionet jo akademike në mjekësi (Kryqi i Kuq zviceran), profesionet akademike në shëndetësi (Zyra federative për shëndetësi) dhe për kualifikimet në fushën e edukimit (Konferenca zvicerane e drejtorëve kantonal për edukim).

## **A mund të themeloj një ndërmarrje?**

Zyra kantonale për stimulimin e ekonomisë (Telefoni 041 819 16 34) ofron informacione rreth mundësive për të themeluar një ndërmarrje në Zvicër.

## **Çfarë duhet bërë në rast papunësie?**

Nëse ju largojnë nga puna, atëherë fillimisht duhet të verifikoni se a janë respektuar afatet për prishjen e kontratës.

Rekomandohet që të lajmëroheni menjëherë pasi ju njoftojnë për vendimin rreth largimit në qendrën regjionale për ndërmjetësimin e punës (RAV). Kërkoni patjetër një vend të ri pune dhe ruani dokumentacionin që keni dërguar për të gjetur një vend të ri pune.

Relatat personale mund të luajnë një rol të rëndësishëm gjatë kërkimit të një vendi pune. Mos hezitoni të shfrytëzoni të gjitha kontaktet tuaja private dhe profesionale.

Vendet e hapura të punës zakonisht afishohen në Zvicër në rubrika të posaçme të gazetave më të mëdha ditore. Edhe në internet mund të gjeni mjaft vende të hapura pune.

Të gjithë të punësuarit me kontratë, të cilët nuk e kanë arritur akoma moshën e pensionet janë të siguruar në mënyrë obligative ndaj papunësisë. Që të mund të paguheni nga fondi i sigurimit ndaj papunësisë duhet të keni punuar gjatë dy viteve të fundit së paku 12 muaj, të banoni në Zvicër, të keni një leje pune dhe të keni qenë aktiv edhe vetë në kërkim të një vendi të ri pune.

Bazuar në marrëveshjen për lëvizjen e lirë të personave ju llogariten edhe kohët që keni punuar me kontratë dhe keni paguar sigurim ndaj papunësisë në një shtet të Bashkësisë Evropiane / EFTA-s.

Që të mund të përfitoni nga pagesat gjatë papunësisë duhet që më së voni ditën e parë të papunësisë të lajmëroheni në qendrën regjionale për ndërmjetësimin e punës RAV. Pas lajmërimit do të pajiseni me më shumë informacione rreth hapave të mëtejme që duhet të ndërmerri.

Enti për punë: [www.sz.ch/arbeit](http://www.sz.ch/arbeit)

Zyra për stimulimin e ekonomisë: [www.schwyz-wirtschaft.ch](http://www.schwyz-wirtschaft.ch)

Mundësitë e punësimit dhe arsimimit në Zvicër: [www.berufsberatung.ch/dyn/8188.aspx](http://www.berufsberatung.ch/dyn/8188.aspx)

Zyra federative për arsim profesional dhe teknologji: [www.bbt.admin.ch](http://www.bbt.admin.ch)

Konferenca e rektorëve të universiteteve zvicerane: [www.crus.ch](http://www.crus.ch)

Kryqi i Kuq zviceran: [www.srk.ch](http://www.srk.ch)

Enti federativ për shëndetësi: [www.bag.admin.ch](http://www.bag.admin.ch)

Konferenca e drejtorëve kantonal për edukim: [www.edk.ch](http://www.edk.ch)

Qendrat regjionale për ndërmjetësim pune RAV: [www.treffpunkt-arbeit.ch](http://www.treffpunkt-arbeit.ch)

# Tatimet

## Cilat tatime janë për t'u paguar?

Kantoni, qarqet, komunat dhe bashkësitë kishtare ngrenë tatime mbi të ardhurat dhe pasurinë e personave me vendbanim ose qëndrim në kantonin Schwyz. Përveç kësaj ka tatime federative që paguhen drejtpërdrejt për konfederatën.

## Si paguhet tatimi?

Të punësuarit e huaj pa autorizim të përhershëm të qëndrimit e paguanë tatimin burimor mbi të ardhurat e tyre. Tatimi burimor hiqet menjëherë nga rroga dhe i dërgohet entit tatimor nga ana e punëdhënësit. Tatim paguhet edhe për të ardhura përmes një sigurimi, si p.sh. pagesat e sigurimit ndaj papunësisë në vend të rrogës.

Personat të cilët e kanë autorizim të përhershëm të qëndrimit ose janë të martuar me një shtetas zviceran ose një person me rezidencë në Zvicër taten në mënyrë të rregullt. Kjo do të thotë që ata bëjnë deklarin e tatimeve një herë në vit. Komuna bën dërgimin e deklaratave si dhe tërheqjen e parave për tatimet e kantonit, qarikut, komunës dhe kishës. Tatimi federativ tërhiqet nga qendra kantonale për arketim.

## Si është përbërja e tatimit burimor?

Tatimi burimor përfshin si tatimet e kantonit, të qarikut dhe të komunës, ashtu edhe ato federative. Për anëtarët e bashkësive fetare katolike dhe evangjeliste llogaritet tatimi duke përfshirë tatimin kishtar. Për të gjithë të tjerët tatimi llogaritet pa tatimin kishtar. Në tarifën e tatimit burimor përfshihen pagesat për sigurimet sociale dhe për shpenzimet profesionale, pagesa e sigurimit dhe e kursimit si dhe të gjitha pagesat e tjera eventuale sociale. Pagesat që nuk përfshihen në këtë tarifë A (kursimet në shtyllën 3a, blerja e viteve të pensionit, alimentacionet, përqindjet e interesit, shpenzimet për shëndetin që i tejkalojnë shumat e parapara si dhe pagesat vullnetare për shoqata bamirëse zvicerane) mund të deklarohen deri më 31 mars të vitit vijues dhe ndikojnë në korrigjimin e tatimit burimor.

## Çfarë duhet të pasur parasysh?

Personat që paguajnë tatim burimor janë të detyruar:

- të njoftojnë menjëherë punëdhënësin dhe zyrën për lajmërimin e banorëve nëse ndryshojnë kushtet e tyre personale (p.sh. martesë, ndarje, ndërrim vendbanimi, etj.).
- të njoftojnë administratën tatimore kantonale nëse kanë të ardhura që nuk përfshihen në tatim (pasuri, alimentacionet, etj.) ose pasuri tjetër.
- t'i japin administratës tatimore kantonale të gjitha informacionet e nevojshme për llogaritjen e saktë të tatimit.



# Siguria sociale



## **Cilat janë parimet në të cilat bazohet sistemi i sigurimit social?**

Siguria sociale përqipet të zbusë pasojat financiare të pleqërisë, invaliditetit dhe papunësisë si dhe të vdekjes së prindërve ose të bashkëshortit. Përveç kësaj të punësuarve iu paguhen shuma të caktuara për fëmijët si dhe nënave gjatë kohës së lindjes.

Sigurimet sociale financohen përmes pagesave të siguruarve, të punëdhënësve si dhe të federatës.

Kërkesat për të përfituar nga sigurimet sociale i duhen drejtuar qendrës përkatëse të sigurimit (sigurimit shëndetësor ose ndaj aksidenteve, fondit barazues të sigurimit të pensionit dhe të trashëgimtarëve -AHV, qendrës për sigurim të invaliditetit -IV, fondit pensional, fondit për të papunësuarit).

## **Si është zgjidhur çështja e përkujdesjes në pleqëri, në rast invaliditeti ose vdekjeje?**

Sistemi i përkujdesjes në Zvicër është ndërtuar në tri shtylla: shtetërore (shtylla e parë), profesionale (shtylla e dytë) dhe private (shtylla e tretë). Këto tri shtylla kanë si synim që të sigurojnë ruajtjen e standardit jetësor në pleqëri, invaliditet dhe në rast vdekjeje për pasardhësit.

## **Sigurimi për pleqëri dhe pasardhësit (Alters- und Hinterlassenenversicherung, AHV) si dhe Sigurimi i invaliditetit (Invalidenversicherung, IV) (shtylla e parë)**

Personat me banim ose vend pune në Zvicër janë të siguruar automatikisht në sigurimin për pleqëri dhe pasardhësit AHV si dhe në sigurimi e invaliditetit (Invalidenversicherung, IV). Pagesat për AHV dhe IV tërhiqen direkt nga rroga.

Pensionin e pleqërisë mund ta marrin meshkujt që kanë mbushur moshën 65 dhe femrat që kanë mbushur moshën 64 vjeçare.

Pensioni për invalidë iu takon të gjithë atyre personave të cilët si pasojë e një sëmundjeje ose aksidenti janë së paku 40% të paaftë për punë.

Pensioni si e ve ose i ve iu takon të gjithë bashkëshortëve që në momentin e vdekjes së bashkëshortit kanë fëmijë ose janë mbi 45 vjeç dhe kanë qenë të martuar së paku 5 vjet. Pensioni si jetim iu takon fëmijëve nën 18 vjeç ose deri në përfundim të arsimit mirëpo maksimumi deri në moshën 25 vjeç.

## **Fondi pensional (shtylla e dytë)**

Sigurimi në shtyllën e dytë e plotëson sigurimin AHV/IV. Të gjithë të punësuarit, të cilët janë të siguruar në shtyllën e parë dhe kanë të ardhura më të larta se 20520 Franga në vit janë detyrimisht të siguruar.

## **Përkujdesja private (shtylla e tretë)**

Përkujdesja private përqipet të mundësojë financimin e standardit jetësor individual të dëshiruar. Sigurimet private ofrojnë mundësi shtesë të përkujdesje private.

### **Kush paguan para, gjatë dhe pas lindjes?**

Pagesat rreth lindjes iu takojnë nënave, të cilat 9 muaj para lindjes kanë qenë të siguruara AHV dhe të cilat gjatë kësaj kohe kanë punuar së paku pesë muaj. Pagesa bëhet në 14 javët e para pas lindjes.

### **Çfarë mundësish ka për familje?**

Përmes ndihmave për familjet neutralizohet ngarkesa financiare e familjeve. Ndihmat për familjet përbëhen nga një pagesë unike prej 1000 Frangash pas lindjes si dhe pagesave mujore prej 200 Frangash për secilin fëmijë. Për fëmijët e rritur deri në 25 vjeç, të cilët janë ende duke u arsimuar bëhet një pagesë mujore për arsim prej 250 Frangash. Këto pagesa bëhen zakonisht nga punëdhënësit.

Për ndihmat për familjet vlejnë rregullat e vendit të punës. Lajmërimi dhe pagesat bëhen përmes punëdhënësit.

### **Kush ndihmon në rast papunësie?**

Shih rubrikën «Puna»

### **Cili sigurim shëndetësor vlen?**

Sigurimi shëndetësor është obligativ për të gjithë banorët e Zvicrës (shih edhe rubrikën «Shëndetësia»). Të gjithë personat duhet të sigurohen ndaj pasojave të sëmundjeve pranë një sigurimi shëndetësor në Zvicër. Kjo vlen parimisht edhe për të gjithë të huajt të cilët qëndrojnë më shumë se 3 muaj në Zvicër ose që punojnë në Zvicër.

Personat me qëndrim të kufizuar në Zvicër si p.sh. punëtorët e huazuar, studentë që marrin pjesë në programe këmbimi, praktikantët dhe stazhierët mund të kërkojnë të lirohen nga obligimi për t'u siguruar në Zvicër nëse sigurimi i tyre personal i përgjigjet kushteve të KGV. Kërkesat për lirim nga obligimi për t'u siguruar i drejtohen zyrës Administrata komunale e banorëve.



# Besimet fetare

## A mund të ushtroj besimin tim fetar?

Në Zvicër ekziston liria e besimit fetar. Çdo njeri është i lirë të zgjedhë dhe të ushtrojë besimin e tij fetar.

Shumica e popullsisë në kantonin Schwyz është katolike. Rreth 13% janë evangjelistë. Edhe shumë bashkësi të tjera fetare janë të përfaqësuara në kanton.

Në secilën komunë gjendet një bashkësi fetare katolike. Drejtojeni Migratio (Nr. i telefonit: 041 210 03 47) nëse dëshironi të informoheni rreth mundësive të kontaktit me pastorët që përkujdesen për të huajt.

Kisha të reformuara evangjelite gjenden në Arth-Goldau, Brunnen, Einsiedeln, Pfäffikon, Küsnacht dhe Lachen.

Informacione rreth mundësive të kontaktit me bashkësitë e tjera fetare jep KomIn (Nr. i telefonit 055 410 28 55).

Kisha katolike dhe ajo evangjelite mund të ngrenë tatime në bazë të ligjeve shtetërore mbi tatimet..

## Cilat festa festohen në kantonin Schwyz?

Në kantonin Schwyz festohen zyrtarisht këto festa:

1 janar (Viti i Ri)

6 janar (Drei Könige – Tre mbretërit)

19 mars (St. Josef – Shën Jozefi)

Karfreitag (E premtja e shenjtë)

Ostersonntag (E diela e pashkëve)

Ostermontag (E hëna e pashkëve)

Auffahrt (Ngjitja në qiell)

Pfingstsonntag (E diela e rrëshajës)

Pfingstmontag (E hëna e rrëshajës)

Fronleichnam – Corpus Christi

1 gusht (Bundesfeiertag – ditë festive federative)

15 gusht (Maria Himmelfahrt)

Eidgenössischer Dank- Buss und Betttag – Dita konfederative e falënderimit, pendimit dhe lutjes

1 nëntor (Allerheiligen – dita e shenjtorëve)

8 dhjetor (Maria Empfängnis – shtatzënia e Marisë)

25 dhjetor (Weihnachten – Krishtlindjet)

26 dhjetor (Stephanstag – Dita e Stefanit)



Shumë komuna kanë përveç këtyre edhe ditë të tjera festive brenda komunave të tyre.

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, shitoreve dhe institucioneve administrative janë të mbyllura gjatë këtyre ditëve. Mësimi në shkolla nuk mbahet.

# Kultura dhe koha e lirë



## Si mund ta kalojmë kohën e lirë?

Natyra plot variacione e kantonit me liqejë, malet dhe kënetat ofron mundësi të shumta për të kaluar kohën e lirë.

Kantoni Schwyz ka një numër të madh shoqatash sportive. Informacione rreth tyre ofron administrata komunale.

Në shumicën e komunave ka biblioteka publike të hapura për të gjithë. Informacione rreth tyre ofron në administrata komunale.

Në bibliotekën kantonale në Schwyz (Rickenbachstrasse 24, Schwyz) ndodhen 26.000 libra nga të gjitha fushat e shkencës, letërsi argëtuese si dhe kasete, CD, CD-ROM dhe DVD për fëmijë, të rinj dhe të rritur.

Në disa prej komunave ka dhe ludoteka. Të rriturit dhe fëmijët mund të huazojnë aty lodra dhe lojëra.

## Çfarë ofertash kulturore ka në kantonin Schwyz?

Në kantonin Schwyz kultura jetohe sidomos në komuna. Ndër ritet e rëndësishme janë:

- Fasnacht (në fillim të vitit)
- Chilbi (në veshhtë)
- Sennenchilbi (në vjeshtë, në fillim të vitit)
- Klausjagen (në dhjetor)

Shoqatat e ndryshme organizojnë rregullisht në shumë komuna shfaqje teatrore, koncerte dhe aktivitete të tjera kulturore.

Në komuna të ndryshme ndodhen edhe muze të ndryshëm. Ndër muzetë më të mëdha janë Bundesbriefmuseum (Muzeu federativ i letrave) si dhe Forumi i historisë zvicerane në Schwyz. Në Einsiedeln ndodhen ekspozita të ndryshme rreth pelegrinazhit si dhe biblioteka Werner Oechslin (Shkrime burimore rreth teorisë së arkitekturës dhe zonave fqinje). Rregullisht organizohen edhe ekspozita në qendrën kulturore Seedamm në Pfäffikon.

Aktivitete në kohën e lirë: [www.schwyz-tourismus.ch](http://www.schwyz-tourismus.ch)

Biblioteka kantonale: [www.sz.ch/kantonsbibliothek](http://www.sz.ch/kantonsbibliothek)

Ludoteka: [www.ludo.ch](http://www.ludo.ch)

Kulturë dhe zakone: [www.schwyzkultur.ch](http://www.schwyzkultur.ch) und [www.schwyz-tourismus.ch](http://www.schwyz-tourismus.ch)

Muze: [www.museums.ch](http://www.museums.ch)

# Lëvizshmëria

## Si mund të lëvizi pa veturë?

Zvicra ka një prej rrjeteve më të dendura të transportit publik. Trena dhe autobusë të ndryshëm qarkullojnë në një takt një- ose gjysëm orësh, madje pjesërisht edhe më shpesh.

Me abonimin Halbtax mund të shfrytëzohen trenat, autobusët dhe anijet në të gjithë vendin me gjysmë çmimi. Me zbritjen familjare «Junior Karte» për familjet mund të merrem falas me vete fëmijët nën moshën 16 vjeçare.

Biletat, abonentë, abonoja Halbtax si dhe «Junior Karte» mund të blihen në stacionet hekurudhore ose të porositen në internet në adresën [www.sbb.ch](http://www.sbb.ch).

«Mobility Car-Sharing» ofron në mbi 1000 qendra në Zvicër mundësinë e shfrytëzimit të veturës pa pasur vetë veturë.

## Çfarë duhet të kenë parasysh shoferët në Zvicër?

Shoferët e huaj mund të përdorin patentën e tyre vetëm gjatë 12 muajve të parë të qëndrimit të tyre në Zvicër. Ata duhet të kenë mbushur moshën 18 vjeçare (vlen për motoçikletat, veturat dhe kamionët).

Para kalimit të këtij afati duhet bërë përshtatja, respektivisht përkthimi i patentës së huaj nga Zyra për qarkullimin rrugor të kantonit Schwyz.

Zyrat për qarkullimin rrugor ndodhen në Schwyz (Schlagstrasse 82) dhe Pfäffikon (Gwattstrasse 3).

Për të parashtruar kërkesën nevojiten dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i kërkesës i plotësuar dhe firmosur
- Leja e qëndrimit ose autorizimi i përhershëm i qëndrimit
- Vërtetimi i vendbanimit
- Origjinali i patentës suaj të shoferit
- Dy foto aktuale për pasaportë
- Vërtetimi i një mjeku të syve ose të një shitoreje optike

Shtetasit e Unionit Evropian /EFTA-s si dhe të Australisë / Zelandës së Re, të Kanadasë / SHBA-ve, të Koresë së Jugut dhe Tajvanit nuk kanë nevojë t'i nënshtrohen detyrimit për të bërë një dëshmuar praktikisht në një provim aftësitë për të drejtuar një automjet.

Autoritetet doganore duhen lajmëruar menjëherë nëse gjatë hyrjes në Zvicër sillni me vete një veturë.

Orare, abonime, zbritje: [www.sbb.ch](http://www.sbb.ch)

Orare të linjave të veçanta: [www.fahrplanfelder.ch](http://www.fahrplanfelder.ch)

Tarifat në kantonin Schwyz: [www.tvsz.ch](http://www.tvsz.ch)

si dhe për zonën Ausserschwyz: [www.zvv.ch](http://www.zvv.ch)

Car-sharing: [www.mobility.ch](http://www.mobility.ch)

Zyra për qarkullimin rrugor (patenta): [www.sz.ch/Verkehrsamt](http://www.sz.ch/Verkehrsamt) > Führerzulassung > Merkblätter

Zyra për qarkullimin rrugor (leja e makinës): [www.sz.ch/Verkehrsamt](http://www.sz.ch/Verkehrsamt) > Fahrzeugzulassung > Merkblätter

# Adresa të dobishme



## Këshillime rreth integritit

KomIn Kompetenzzentrum für Integration  
Bahnhofstrasse 1 (Prej 1.10.2009 Centralstrasse 18)  
6410 Goldau  
Telefonii 055 410 28 55  
www.kom-in.ch

Schindellegistrasse 1  
8808 Pfäffikon  
Telefoni 055 410 28 55  
www.kom-in.ch

## Ndërmjetësimi i përkthyesve

Dolmetschdienst Zentralschweiz  
Telefoni 041 368 51 51

[www.dolmetschdienst.ch](http://www.dolmetschdienst.ch)

## Oferta për integrim

[www.integration-zentralschweiz.ch](http://www.integration-zentralschweiz.ch)

## Stimulimi i ekonomisë

Amt für Wirtschaft  
Bahnhofstrasse 15  
6431 Schwyz  
Telefoni 041 819 16 34

[www.schwyz-wirtschaft.ch](http://www.schwyz-wirtschaft.ch)

## Qendra e informimit për arsim profesional

Huobstrasse 9 8808 Pfäffikon Telefoni 055 417 88 99	Parkstrasse 25 6410 Goldau Telefoni 041 859 14 44
---	---

Paracelsuspark 3  
8840 Einsiedeln  
Telefoni 055 412 33 49  
[www.sz.ch/berufsberatung](http://www.sz.ch/berufsberatung)

## Qendra profesionale për këshillim të çifteve dhe familjeve

Fachstelle für Paar- und Familienberatung Centralstrasse 5d 6410 Goldau Telefoni 041 859 17 37	Oberdorfstrasse 2 8808 Pfäffikon Telefoni 055 410 46 44
---	---

[www.spd.ch](http://www.spd.ch)

## Qendër informative dhe këshilluese për gra

Informations- und Beratungsstelle für Frauen  
Schlössliweg 1  
8853 Lachen  
Telefoni 0800 00 30 30

[www.ibf-schwyz.ch](http://www.ibf-schwyz.ch)

## Këshillime rreth problemeve personale dhe financiare

Nëse keni probleme personale dhe financiare mund t'i drejtoheni shërbimit social të komunës suaj. Komuna mund të ndërmjetësojë edhe me ndihmë materiale si p.sh. ushqime më të lira. Më shumë informacione mund të merrni pranë administratës komunale.

---

# Njoftim ligjor

— Ky publikim shërben si informacion. Nuk ka të drejta që rrjedhin nga ky publikim dhe që mund të bazohen në të. Edhe pse jemi të kujdesshëm që të dhënat tona të jenë pa gabime, prapëseprapë nuk mund të marrim përgjegjësinë për saktësinë dhe tërësinë e këtyre të dhënave. Përmbajtja e këtij publikimi mund të ndërrohet pa paralajmërim. Sa i përket këtij publikimi, ne nuk marrim përgjegjësi për përmbajtjen dhe shërbimet e ofrurara nëpër faqe të internetit. Përdoruesi i viziton këto faqe në përgjegjësi të tij.





**Ngulis****Botuesi:**

Volkswirtschaftsdepartement  
Kanton Schwyz  
Postfach  
6431 Schwyz  
[www.sz.ch](http://www.sz.ch)

**Pamja dhe shtypi:**

ea Druck + Verlag AG, Einsiedeln

**Fotot:**

Fotolia, [www.fotolia.de](http://www.fotolia.de)

© 2009

Volkswirtschaftsdepartement Kanton Schwyz  
Kopjet dhe citatet lejohen nëse shënohet burimi